



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1650 Prot.

Tiranë, më datë 02.12.2021

VENDIM  
Nr. 655, datë 02.12.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 02.12.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e *Relacionit të verifikimit në terren në kuadër të gjetjes rastësore arkeologjike: fragment kolone në fshatin Ngurës, Lushnje*”, hartuar nga Drejtoria e Shërbimit Arkeologjik pranë IKTK-së, në bashkëpunim me specialistët e Muzeut Historik të Lushnjes;
2. Të bëhet regjistrimi i objektit pranë Institutit Kombëtar të Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore;
3. Të realizohet një vëzhgim arkeologjik sipërfaqësor nga DSHA, përreth zonës që është konstatuar gjetja arkeologjike;
4. Objekti i gjetur të depozitohet dhe të ekspozohet në Muzeun Historik të Lushnjes;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR  
Rudina ZOTO



KRYETAR  
Elva MARGARITI